



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 642/3 Prot.

Pogradec, më 15.02.2024

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim dhe miratim

KRYETAR I KESHILLIT BASHKIAK

E nderuar Kryetare, Znj. Manjola Kamolli

Bashkegjitur po ju dergojme per shqyrtim dhe miratim Projekt Vendimin per:

PËR NJE SHTESE NE VKB NR 140 DT 28.12.2023
“MIRATIMIN DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË POGRADEC PËR VITIN 2024”



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: ____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: ____

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: ____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2024

PROJEKT-VENDIM

NR. _____, DATË ____ . ____ .2024

PËR

**NJE SHTESE NË VENDIMIN NR 140 DT 28.12.2023, PËR MIRATIMIN DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË POGRADEC PËR VITIN 2024"**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Per menaxhimin e sistemit buxhetor te Republikes te Shqiperise", i ndryshuar, Ligjin nr.152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin"; V.K.M nr.1108, date 30.12.2015 "Per transferimin nga Ministria e Bujqesise, zhvillimin rural dhe administrimit te ujrave te Bashkite, te infrastruktures te ujitjes dhe kullimit", V.K.M nr.915, date 11.11.2015 "Per transferimin ne pronesi, nga Keshillat e Qarqeve te Bashkite, te rrjetit te rrugeve rurale dhe te aseteve te luajtshme dhe te palujtshme te ndermarjeve te mirembajtjes se ketyre rruheve"; V.K.M nr.433, date 08.06.2016 "Per transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve, kullotave publike sipas inventarit, dhe aktualisht ne administrim te Ministrise te Mjedisit e te ish komunave/bashkive", Udhezimit te Ministrise se Financave nr.2, date 06.02.2012, "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit", i ndryshuar; Shkresa nr 20079 dt 03.11.2023 "Dergohet transferta e pakushtezuar e pergjithshme dhe sektoriale per vitin 2024" dhe VKB 140 dt 28.12.2023 " Miratimin dhe detajimin e buxhetit të bashkisë Pogradec për vitin 2024" Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:



1. Te miratoje shperndarjen e Fondeve te trasheguara nga viti 2023 si me poshte vijon:

- Ne tabelen e meposhtme jane te ndara te gjitha fondet e trasheguara nga viti 2023 sipas programeve ekonomike ose Ndermarrjeve ne varesi te Bashkise.

Nr	Institucioni	Fonde te celura	Te ardhura te pacelura	Fonde nga 06	Total
1	Bashkia	6,012,777	4,136,088	8,664,265	18,813,129
2	MZSH	13,270,500			13,270,500
3	NMIPP	41,326,037			41,326,037
4	Q.Arsimore	10,966,262			10,966,262
	Total	71,575,576	4,136,088	8,664,265	84,375,928

- Per vitin 2024 Bashkia Pogradec do te beje nje rishperndarje te fondeve si me poshte vijon:

Nr	Institucioni	Fonde Specifike	Fonde nga 06	Fonde te kerkuara nga Ndermarrjet
1	Bashkia	6,952,172	8,664,265	15,616,437
2	MZSH	13,270,500		13,270,500
3	NMIPP	44,522,729		44,522,729
4	Q.Arsimore	10,966,262		10,966,262
	Total	75,711,663	8,664,265	84,375,928

3. Për zbatimin e vendimit të ngarkohet Kryetari i Bashkise, te gjitha drejtorite, Ndermarrjet ne varesi pranë Bashkise Pogradec.

4. Vendimi të hyjë në fuqi 10 dite pas shpalljes.



KRYETAR

Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2024

Relacion

Ne baze te VKB nr 140 dt 28.12.2023 "Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2024", po ju paraqesim Fondet e trashguara nga viti 2023 si me poshte:

Nr	Institucioni	Fonde te celura	Te ardhura te pancelura	Fonde nga 06	Total
1	Bashkia	6,012,777	4,136,088	8,664,265	18,813,129
2	MZSH	13,270,500			13,270,500
3	NMIPP	41,326,037			41,326,037
4	Q.Arsimore	10,966,262			10,966,262
	Total	71,575,576	4,136,088	8,664,265	84,375,928

Tek tabela e parë e paraqitur në Projekt Vendim janë të paraqitura të gjitha fondet e mbetura nga viti 2023 sipas programeve buxetore. Tek tabela e dytë e paraqitur janë të specifikuara sesi do të rishpërndahen këto fonde:

Nr	Institucioni	Fonde Specifike	Fonde nga 06	Fonde te kerkuara nga Ndermarrjet
1	Bashkia	6,952,172	8,664,265	15,616,437
2	MZSH	13,270,500		13,270,500
3	NMIPP	44,522,729		44,522,729

4	Q.Arsimore	10,966,262		10,966,262
	Total	75,711,663	8,664,265	84,375,928



1. Bashkia do të ketë shumën prej 6,952,172 lekë. Të gjitha fondet janë për Mbikeqyrjet dhe Kolaudim e investimeve të cilat janë akoma në proces. Duke qënë se nuk kanë përfunduar akoma, ju transferohen fondet për këtë vit. Gjithashtu fondet e kapitullit 06 janë fonde të cilat çelen për pagesën e tatimit të thjeshtuar të fitimit dhe për pagesën e UK SH.A. nga kjo shumë një pjesë të konsiderueshme zë dhe Sponsorizimi nga Ambasada Japoneze fondi (7,327,692 leke) për blerjen e nje makine Eskavator. Te ardhurat e paçelura jane te ardhurat e mbledhura gjate muajit Dhetor te cilat nuk jane çelur.

2. Sektori i Zjarrfikësve (MZSH) trashëgon shumën prej 13,270,500 lekë. Këto janë fonde të papërdorura të cilat do të ripërdoren për blerje të ndryshme dhe për fondin e pagës.

3. NMIPP trashëgon fonde specifike nga sektorët në shumën 41,326,037 lekë dhe do të ketë shtesë nga Bashkia për blerjen e materialeve te ndryshme. Kjo shumë vjen si shkak i transferimit të fondeve specifike të cilat nuk jane përdorur. Gjithashtu gjatë muajve NMIPP ka marrë fonde nga Bashkia për blerje të ndryshme dhe duke qënë se nuk ka mundur të bëjë likuidim e faturave këto fonde transferohen.

4. Qendra Arsimore trashëgon shumën prej 10,966,262 lekë e cila është mbetje nga fondet e specifike të Ministrisë.

Ju faleminderit!

PËRGATITI MATERIALIN:

Konceptoi : I. Karapança

Miratoi: D.Babasuli

**KRYETAR
ILIR XHAKOLLI**